



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 598/4 Prot.

Durrës, më 20.3.2024

VENDIM

Nr. 19, datë 20.3 2024

PËR

"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" NË FAKULTETIN E BIZNESIT"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të shkresës nr. 561 prot., datë 13.03.2024 të Zv.Rektorit për Çështjet Mësimore, të shkresës nr. 77 prot., datë 05.02.2024 të Fakultetit Biznesit, të Vendimit nr. 1 datë 26.01.2024 të Komisionit të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për Funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në Fakultetin e Biznesit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv.Rektorët,
 - Dekani i Fakultetit të Biznesit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 598/19 Prot.

Durrës, më 20.3.2024

VENDIM

Nr 24, datë 20.3.2024

“MBI LISTËN E PROJEKTEVE KËRKIMORE SHKENCORE PËR CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË SHKENCA EKONOMIKE, E SAKTËSUAR PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË FAKULTETIN E BIZNESIT PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU“ DURRËS”.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 46, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të Statutit të UAMD-së, organeve drejtuese dhe strukturave të tjera të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të shkresës së Fakultetit Biznesit nr.58 prot, date 30.01.2024, të shkresës me nr. 207 prot, datë 19.03.2024 “Dërgohet lista e projekteve kërkimore shkencore për Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë në “Shkenca Ekonomike” e saktësuar për vitin akademik 2024-2025, Fakulteti i Biznesit” në UAMD”, Senati Akademik

V E N D O S I :

- Miratimin e listën e projekteve kërkimore shkencore për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” në “Shkenca Ekonomike”, e saktësuar për vitin akademik 2024-2025, në Fakultetin e Biznesit pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu“ Durrës.
 - Organizimi i strategjive të çmimit përmes analizës së të dhënave modelimeve statistikore.
 - Ekonomia qarkulluese, modelet e biznesit dhe inovacionit, elementët kryesorë për një tranzicion të qëndrueshëm në ekonominë qarkulluese të Shqipërisë.
 - Globalizimi i ekonomisë kombëtare i lidhur me parametra makroekonomikë.
 - Shqyrtimi i zhvillimit financiar dhe inovacionit teknologjik në vendet e ballkanit: Një perspektivë mbi energjinë e ripërtëritshme, me kusht dorëzimin e dokumenacionit të domosdoshëm për miratimin përfundimtar të tij.
 - Ndikimi i marketingut digjital në përmirësimin e shërbimeve dhe ndërkombëtarizimin e bizneseve në Shqipëri.
 - Teknikat inovatore të marketingut në telemedicinë dhe shëndetin dixhital.
 - Skema e garancisë së kredisë si mundësi aksesit në financim dhe zhvillim për NVMV (sme) në Shqipëri.
- Projektet miratohen pa efekte financiare.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:

- Zv. Rektorët
- Drejtuesi i Njësisë Kryesore.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

